

**AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI I SHOQËRISË “CGL NUOVE COSTRUZIONI” SHPK**

THEMELIMI

**Neni 1
Ortaku themelues**

1.1 Shoqëria “CGL NUOVE COSTRUZIONI” SH.P.K. themelohet nga Ortaku: Z. Giancarlo Consonni, shtetas italian, lindur më 02.05.1959 ne Arosio (CO), Itali, rezident ne Arosio (CO), Itali, mbajtes i Pasaportes me Nr. YA9936221 me zotesi te plete per te vepruar;

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

**Neni 2
Emërtimi**

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “CGL NUOVE COSTRUZIONI” SH.P.K.

**Neni 3
Forma ligjore**

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4
Baza ligjore**

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

**Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë**

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

**Neni 6
Selia**

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Besim Alla, Pallati Alfa, Hyrja 4, Zyra nr.14, Yzberisht, Kashar, Tirane.

6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

**Neni 7
Emblema. Vula**

7.1 Shoqëria do të ketë emblemët dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.

7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnë emblemën dhe vulën e saj.

Neni 8
Objekti

8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

- Ofrimi i sherbimeve te konsulences ne fushen e ndertimit
- Ndertimi i ndertesave civile dhe industriale
- Restaurim dhe mirembajtje e pasurive te paluajtshme te vendosura ne mirebesim
- Ndertim, restaurim dhe mirembajtje te rrugeve Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 9
Kapitali

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 ALL (Njeqind mijë ALL).

9.2 Kapitali ndahet në 1 (nje) pjesë.

9.3 Pjesa e kapitalit zotërohet 100% nga Ortaku i vetem.

9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

10.1 Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

10.2 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.

10.3 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 11
Rritja e kapitalit

11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 12
Zvogëlimi i kapitalit

12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Ortakut te vetem te shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Ortakut te vetem raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem të shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Vendimet e ortakut të vetëm

13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren prej Asamblese se Ortakut te vitem.

13.2 Vendimet e Asamblese se Ortakut te vetem përfshijnë kryesisht:

- Ndryshimin e selisë ose të emërtimit të shoqërisë;
- Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- Prishjen dhe likujdimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë;
- Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.
- Vendimarrjen per investime te reja ne fushen e pasurive te paluajtshme brenda apo jashte territorit shqiptar.

Neni 14

Administrimi

14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.

14.3 Administratori i shoqërisë eshte *Z. Giovanni Latorrata, shtetas italian, lindur më 23.05.1947 ne Castellaneta (TA), Itali, rezident ne Cermenate (CO), Itali, mbajtes i Pasaportes me Nr. YB5567159 me zotesi te plote per te vepruar;*

14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
 - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
 - Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri apo kudo jashte saj tek palët e treta, insitucionë apo entitete publike ose private,
 - Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
 - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm përmbarëvajtjen e biznesit;
 - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar,
 - Të hape dege ose zyre perfaqësimi, qe konsiderohen te nevojshëm përbiznesin e shoqërisë.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm përpesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 15

Viti finanziar

15.1 Viti finanziar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë finanziar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16
Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i vetem dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatumore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 17
Te Ardthurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardthurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahan ndërmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zoterojnë në kapitalin e shoqërisë.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18
Likujdimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem.
- 18.2 Me vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem caktohet një likujdator ose një grup likujdatorësh që do të plotësojnë procedurat e likujdimit.
- 18.3 Likujdatori do të përgatisë raportin e likujdimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rrith operacioneve të mëtejshme të likujdimit dhe kohën që nevojitet përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedurë, Asambleja e Ortakut te vetem do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likujdimit.

Neni 19
Mosmarrëveshjet

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 23.03.2021

ORTAKU:
Z. Giancarlo Consonni

